



RAPORTET E MONITORIMIT, TAKIME ME KRYETAR TË KOMUNAVE



Pas përfundimit të monitorimit të punëve kadastrale të Zyrave Kadastrale Komunale, të kompanive të licencuara gjeodete dhe të gjeodetëve të licencuar si dhe pas publikimi të raportit me të gjeturat e monitorimit, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti ka ndërmarrë një seri vizitash nëpër komuna ku me Kryetarët e Komunave kanë trajtuar të gjeturat dhe kanë identifikuar veprimet për tejkalimin e pengesave eventuale të evidentuara në raportet e monitorimit. Për këtë arsye me datat 3, 9, 11, 16, 18 dhe 25 shtator, z. Ahmeti ka mbajtur takime gjithëpërfshirëse të punës me Kryetarët e Komunave Fushë Kosovë, Klinë, Malishevë, Lipjan, Rahovec dhe Artanë, gjatë të cilave takime janë trajtuar temat e interesit të përbashkët si dhe janë identifikuar mundësitë për bashkëpunim. Sa i përket të gjeturave të monitorimeve, z. Ahmeti ka informuar Kryetarët e Komunave që disa parregullësi janë duke u shfaqur rregullisht, monitorim pas monitorimi, si dhe ka paralajmëruar që pas raportit të tetë të monitorimit i cili pritet të zhvillohet muajve të ardhshëm, në rastet kur do të evidentohen parregullsitë e njejta, Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka për obligim ligjorë të marrë masa konform legjislacionit në fuqi e që mund të rezultojnë edhe me ndërprerjen e qasjes në Sistemin e Informacioneve Kadastrale

për Tokën në Kosovë për komunat specifike. Kryetarët e Komunave dhe Drejtorët e Zyrave Kadastrale Komunale janë zotuar që të trajtojnë me seriozitet të gjeturat dhe të veprojnë me qëllim të shmangies së parregullsisë. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit në të ardhmen, ai u fokusua në kuadër të projektit të Bankës Botërore për pronë të paluajtshme dhe infrastrukturë gjeohapësinore (REGIP), i cili së fundi është ratifikuar nga parlamenti i Republikës së Kosovës. Agjencia Kadastrale e Kosovës si përfituese e këtij projekti ka filluar me aktivitete konkrete për implementimin e tij. Në kuadër të projektit REGIP njëra nga komponentat, Komponenta B – “Modernizimi i Kadastrit”, si aktivitet kryesor ka Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale në rreth 100 Zona Kadastrale në të gjitha Komunat e

Republikës së Kosovës. Për më shumë janë edhe disa aktivitetet tjera nga të cilat mund të përfitojë Komunitet, si që është vendosja e numrave të adresave, pajisja me inventar e teknologji të informacionit e ngjashëm. Duke qenë se takimet kanë pasur të njëjtën agjendë, si konkluzion i takimeve ka qenë që takimet e tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen, qoftë në nivel të lartë e qoftë në nivel teknik, krejt me qëllim të avancimit të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.



Kryeshefi i AKK, takim me Zëvendës Kryeministrin z. Besnik Tahiri



Me qëllim të prezantimit të aktiviteteve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në fushën e administrimit të regjistrave pronësor, hartografisë, kadastrës dhe gjeodezisë, me datë 23 Shtator është mbajtur një takim pune mes Zëvendës Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Besnik Tahirit dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti. Në takim u bisedua edhe për fushat

e bashkëpunimit në të ardhmen me theks të veçantë përkrahja qeveritare për avancimin e administrimit të tokës në Republikën e Kosovës. Po ashtu, Kryeshefi Ahmeti prezantoi shkurtimisht edhe nevojën për avancimin e legjislacionit, krejt me qëllim të mundësit të AKK-së që të ndjek trendet e shteteve të zhvilluara në fushat të cilat janë brenda mandatit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Z. Ahmeti në fund të takimit ia dhuroi z. Tahirit literaturën profesionale e cila avancon çështjet kadastrale dhe pronëso-juridike në Kosovë e të cilën ekspertët e AKK e kanë zhvilluar së fundmi me qëllim të lehtësimit të punëve të gjithë të përfshirëve në këtë fushë dhe me qëllim të avancimit të shërbimeve që iu ofrohen institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përfaqësues të Ambasadës Amerikane dhe të FSK vizitojnë AKK



Me qëllim të informimit të ndërsjellë rreth aktiviteteve të institucioneve respektive, me datë 2 Shtator në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) është mbajtur takim pune mes Kryeshefit Ekzekutiv të AKK-së z. Avni Ahmeti dhe përfaqësuesve të Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë. Qëllimi i takimit ishte identifikimi i mënyrave më të mira për shpërndarjen e të dhënave mes institucioneve me qëllim të avancimit të kualitetit të shërbimeve të ndryshme, e me theks të veçantë ato të sigurisë që

ofrohen për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Po ashtu, pas një takimi të frytshëm e interaktiv përfaqësuesit e FSK dhe të Ambasadës Amerikane vlerësuan lartë bashkëpunimin me AKK-në dhe gatishmërinë e këtij institucioni të ndihmojë qoftë me produkte e shërbime e qoftë me ekspertizë, sa herë që është kërkuar e gjithmonë bazuar në ligjet në fuqi. Palët pjesëmarrëse në takim u pajtuan që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen, sidomos në fushat që konsiderohen të interesit të përbashkët.

Memorandum bashkëpunimi AKK-AKI



Me datë 14 shtator në ambientet e AKK është mbajtur një takim pune mes Kryeshefit Ekzekutiv z. Avni Ahmeti dhe Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës z. Kreshnik Gashi në të cilin është nënshkruar Memorandum për Bashkëpunim ndërmjet AKK-së dhe AKI-së. Ky memorandum është bazuar në fushë-veprimtarinë kushtetuese dhe ligjore të këtyre dy institucioneve dhe përbën avancim të bashkëpunimit ekzistues ndër-institucional.

Informata mbi AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në vijim të tekstit AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore (në vijim të tekstit, IKIH) dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

Kontakte

KRYESHEF EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR
bashkim.shaqiri@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCEVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Afërdita Thaçi
Afërdita.Thaçi@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net

AKK, takim pune në Agjencinë Kundër Korrupsionit



Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) si autoritet qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale ofron të dhëna për institucione publike në mesin e të cilave edhe për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Së fundi, si pjesë e zhvillimeve teknologjike AKK është duke avancuar nga mënyra tradicionale e ofrimit të të dhënave (letër, email, CD) në ofrimin e të dhënave në rrjet e në kohë reale. Avancimi në këtë formë të ofrimit të të dhënave do të përshpejtojnë shkëmbimin e të dhënave, do të ndikonte në ngritjen e sigurisë së të dhënave, do të garantonte konfidencialitetin e tyre, do të ngriste kualitetin e ofrimit të shërbimeve e ngjashëm. Prandaj për të

identifikuar mënyrat e implementimit të kësaj teknologjie dhe për të identifikuar hapat e bashkëpunimit mes AKK-së dhe Institucioneve tjera të interesit, me datë 10 Shtator në ambientin e Agjencisë Kundër Korrupsionit është mbajtur takim pune mes ekipeve gjithëpërfshirëse të institucioneve, respektivisht Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe Zyrtari i Lartë Ligjor z. Bashkim Shaqiri u prit nga z. Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit i shoqëruar nga bashkëpunëtorët z. Afrim Atashi dhe z. Agron Berani. Në takim po ashtu u diskutua edhe mbi aktivitetet e ardhshme të interesit të përbashkët ku bashkëpunimi do të mund të avancohej, krejt me qëllim të ngritjes së kualitetit të produkteve, avancimit të shkëmbimit të të dhënave dhe avancimit të kualitetit të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

AKK, takim me drejtorët e ri në dy ZKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës si organ kompetent për mbikëqyrjen e punëve kadastrale që kryhen nga Zyrat Kadastrale Komunale, si dhe si përgjegjëse për administrimin e qasjeve në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë është në kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e ZKK-ve, qoftë në nivelin teknik e profesional e qoftë në nivelin menaxherial. Për këtë arsye, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti në dy takime të ndara priti dy drejtorë të emëruar të ri të Zyrave Kadastrale Komunale, respektivisht z-njën Nora Kelmendi, Drejtoreshë e Zyrës Kadastrale Komunale në Prizren dhe z. Nebojsja Periç, Drejtor në Zyrën Kadastrale Komunale në Graçanicë. Në takimet në fjalë, drejtuesit e institucioneve respektive shkëmbyen informacione të ndërsjella rreth aktiviteteve, projekteve e sifdave si dhe diskutuan mbi identifikimin e hapave që mund të ndërmerren bashkërisht, me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Përmbaaruesve

Si rezultat i bashkëpunimit intenziv në fushën e shkëmbimit dhe ofrimit të të dhënave mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Odës së Përmbaaruesve Privat të Kosovës (OPPK) si në rrafshin menaxherial po ashtu edhe në atë teknik e profesional, me datë 17 shtator në ambientin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur një takim pune mes prijësve të institucioneve respektive, z. Avni Ahmeti dhe z. Arben Gashi. Gjatë takimit janë diskutuar dhe trajtuar parimet përfundimtare për implementimin e shkëmbimit të të dhënave përmes ueb shërbimeve, respektivisht pjesa ligjore dhe teknike që do të bënin të mundshme një gjë të tillë. Pas trajtimit të këtyre aspekteve, takimi kulmoi me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit i cili ka për qëllim krijimin dhe avancimin e



bashkëpunimit mes palëve nënshkruese për qasjen në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme përmes ueb shërbimeve. Përmes këtij memorandum AKK dhe OPPK po ashtu krijojnë Procedura Standarde të Operimit për shkëmbimin e shënimeve ku edhe definohet lloji i të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivelin teknik të shkëmbimit të informatave si dhe çmimi i pagesës për ofrimin e këtyre



shërbimeve. Memorandum lidhet në afat të pacaktuar ndërsa palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë memorandum. Në fund të takimit, Kryetari i Odës së Përmbaaruesve i ndau një mirënjohje Kryeshefit Ekzekutiv të AKK-së z. Avni Ahmeti si shenjë falënderimi për gatishmërinë e përhershme për bashkëpunim.

Thellohet bashkëpunimi me Njësinë për Inteligjencë Financiare



Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI). Si e tillë, Agjencia Kadastrale e Kosovës ofron të dhëna për institucione publike në mesin e të cilave edhe për Njësinë për Inteligjencë Financiare. Së fundi, si pjesë e zhvillimeve teknologjike

AKK është duke avancuar nga mënyra tradicionale e ofrimit të të dhënave (letër, email, CD) në ofrimin e të dhënave në rrjet e në kohë reale, përmes ueb shërbimeve. Avancimi në këtë formë të ofrimit të të dhënave do të përshpejtojë shkëmbimin e të dhënave, do të ndikojë në ngritjen e sigurisë së të dhënave, do të garantojë konfidencialitetin e tyre, do të avancojë kualitetin e ofrimit të shërbimeve engjashëm. Prandaj për të identifikuar mënyrat e implementimit të kësaj teknologjie dhe për të identifikuar hapat e bashkëpunimit

mes AKK-së dhe Institucioneve tjera të interesit, me datë 22 Shtator në ambientit e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur takim pune mes ekipeve gjithëpërfshirëse të institucioneve, respektivisht Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe Zyrtaari i Lartë Ligjor z. Bashkim Shaqiri priti përfaqësues të Njesisë për Inteligjencë Financiare respektivisht z Behar Xhema, Zv.Drejtor i Njesisë për Inteligjencë Financiare, z-nja Flutra Blakçori Xërxa, Udhëhëse e Sektorit Ligjor dhe z Zijadin Canolli, Udhëheqës i Sektorit të IT. Në takim po ashtu u diskutua edhe mbi aktivitetet e ardhshme të interesit të përbashkët ku bashkëpunimi do të mund të avancohej, krejt me qëllim të ngritjes së kualitetit të produkteve, avancimit të shkëmbimit të të dhënave dhe avancimit të kualitetit të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Shpërndahen licencat për gjeodetë



Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI). Si e tillë, Agjencia Kadastrale e Kosovës ofron të dhëna për institucione publike në mesin e të cilave edhe për Njësinë për Inteligjencë Financiare. Së fundi, si pjesë e zhvillimeve teknologjike

AKK është duke avancuar nga mënyra tradicionale e ofrimit të të dhënave (letër, email, CD) në ofrimin e të dhënave në rrjet e në kohë reale, përmes ueb shërbimeve. Avancimi në këtë formë të ofrimit të të dhënave do të përshpejtojë shkëmbimin e të dhënave, do të ndikojë në ngritjen e sigurisë së të dhënave, do të garantojë konfidencialitetin e tyre, do të avancojë kualitetin e ofrimit të shërbimeve engjashëm. Prandaj për të identifikuar mënyrat e implementimit të kësaj teknologjie dhe për të identifikuar hapat e bashkëpunimit

mes AKK-së dhe Institucioneve tjera të interesit, me datë 22 Shtator në ambientit e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur takim pune mes ekipeve gjithëpërfshirëse të institucioneve, respektivisht Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe Zyrtaari i Lartë Ligjor z. Bashkim Shaqiri priti përfaqësues të Njesisë për Inteligjencë Financiare respektivisht z Behar Xhema, Zv.Drejtor i Njesisë për Inteligjencë Financiare, z-nja Flutra Blakçori Xërxa, Udhëhëse e Sektorit Ligjor dhe z Zijadin Canolli, Udhëheqës i Sektorit të IT. Në takim po ashtu u diskutua edhe mbi aktivitetet e ardhshme të interesit të përbashkët ku bashkëpunimi do të mund të avancohej, krejt me qëllim të ngritjes së kualitetit të produkteve, avancimit të shkëmbimit të të dhënave dhe avancimit të kualitetit të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.